



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:172651

Datë: 21.04.2021

Numri i dokumentit: 01717079

PKR.nr.290/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, me Kryetaren e trupit gjykues Violeta Husaj Rugova, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Besa Dervishaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarës A. Sh. nga Peja, rruga “Bajram Kelmendi”, nr.3, për veprën penale, “falsifikim i rezultateve të votimit” nga neni 219 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda PP/L.nr.200/20 të datës 18.12.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencë të Prokurorit të shtetit Valbona Disha Haxhosak, të akuzuarës A. Sh. , me datë 12.04.2021 mori dhe shpalli, si dhe me datë 19.04.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

A. Sh. , e bija e Gj. dhe e nënës E. e gjinisë D., e lindur me datë në fshatin, Komuna, tani me banim në, rruga “.....”, nr.3 e pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme të mjekësisë, punëtoreshë në laborator “.....” në Pejë, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal, Shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTORE

Për shkak se:

Me datë 11.06.2017 në, duke keqpërdorur pozitën apo autorizimin e saj lidhur me zgjedhjet ka regjistruar në mënyrë të pasaktë rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore, në atë mënyrë që e pandehura ditën kritike e cila ishte e autorizuar nga KQZ si kryetare e komisionit zgjedhor në vendvotimin me numër 1702C/03R që gjendej në shkollën fillore “.....” në, pikërisht pas numërimit të votave në FRK (Formularin i Rezultateve të Kandidatëve) në kundërshtim me nenin 102 par.2 të Ligjit NR.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ka regjistruar gabimisht votat e kandidatëve, duke regjistruar 16 vota më pak si dhe 114 vota më shumë, me çrast me gjithsejtë 130 vota i ka dëmtuar kandidatët e ndryshëm brenda subjekteve politike për zgjedhjet e përgjithshme,

-Me çka ka kryer veprën penale “falsifikim i rezultateve të votimit nga neni 219 par. 2 lidhur me par.1 të ish KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 7,41,49,50,51,52,73, nenit 219 par. 2 lidhur me par.1 të ish KPRK-së si dhe nenin 365 të KPPRK-së të akuzuarës i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Të njëjtës i përcaktohet dënim me burg në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se e akuzuara brenda periudhës 1 (një) vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

E akuzuara obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj gjykatës shumën prej 15 €, në emër të paushallit gjyqësor gjykatës ti paguaj shumën prej 15 € dhe shumen prej 50 euro në emër të kompensimit për viktimat e krimit, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

REFUZOHET propozimi i prokurorisë që konform nenit 65 të KPRK-së të akzuares ti shqiptohet dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të funksionit në administratën publike apo shërbimin publik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.200/20 të datës 18.12.2020, ndaj të akuzuarës A. Sh. nga, rruga “.....”, nr.3, për vepër penale, “falsifikim i rezultateve të votimit” nga neni 219 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit PP/I.nr.200/20 të datës 18.12.2020, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se e akuzuara e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarës i ka dhënë mundësinë që të deklarohej për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarën për rendësin dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe e akuzuara A. Sh. ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat e pranimin të fajësisë dhe se e pranon fajësinë për veprën penale siç është e cekur në dispozitivin e aktakuzës, pasi që i ka të qarta pasojat dhe përpirësit e pranimin të fajësisë të cilat i janë shpjeguar nga ana e Gjykatës dhe pas shpjegimeve të bërë nga Kryetarja e trupit gjykues, deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe këtë pranim e bënte vullnetarisht.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se meqenëse e akuzuara e ka pranuar fajësinë i cili pranim është i bazuar edhe në prova në bazë të cilës është ngritë aktakuza i propozon Gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: Libri i votimit, formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve me numër vendvotimi 1702C/03R, formulari i rezultatit të kandidatëve me numër vendvotimit 1702C/03R, formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve pas rinumërimit, tabela e specifikuar (në exel) me emrin e kandidatit, subjektit politik dhe pasqyra e votave të numëruara dhe rinumëruara, akti përcjellës i kryeprokurorit të shtetit me numër PPN.nr.72/2020 të datës 06.05.2020, shkresa njoftuese për pasaktësinë e identifikuar nga KQZ, rastet për hetim të identifikuar nga KQZ,

deklarata e të dyshuarës e dhënë në polici me datë 06.11.2020, deklarata e të pandehurës e dhënë në Prokurori me datë 17.12.2020, andaj gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarës ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e për të cilin është shpallur fajtoare.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 73 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se e ka pranuar fajësinë qysh në fillim, pati sjellje korrekte në shqyrtim fillestar, është penduar, për gjykatën nuk ka të dhëna se e njëjta më parë ka ra ndesh me ligjin, ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarën e lartcekur gjykata nuk ka gjetë asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarën e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të saj dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarës në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarën në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarën që ti paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Gjykata ka refuzuar propozimin e prokurorisë për shqiptimin e dënimit plotësues ndalimi i ushtrimit të funksionit në administratën publike apo shërbimin publik, pasi që vlerësoj se detyra e komisionarit në zgjedhje pushon me mbarimin e zgjedhjeve dhe certifikimin e tyre, e kjo bazuar në nenet 74,75,76 Ligji nr. 03/1-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Dënimi plotësues i propozuar nga prokuroria kryesisht shqiptohet kur kemi të bëjmë me kapitullin e veprave penale kundër detyrës zyrtare (shih komentarin e kodit penale neni 65, ku theksohet se ky dënim plotësues shqiptohet te verat penale nga neni 422-437).

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,**

2020:172651, 21.04.2021

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.